

Bazuar në kompetencat e Komitetit Konsultativ për Persona me Nevoja të Veçanta (më tutje: Komiteti) të dala nga Vendimi 01 i Komisionit Intervistues të Kuvendit Komunal të Prishtinës, nr. 031 - 67047, datë 24.03.2016. dhe për t'i definuar dhe qartësuar më tej detyrat dhe përgjegjësitë e veta brenda atyre kompetencave, duke u bazuar në dispozitat përkatëse të Legjislacionit për Persona me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës, si dhe duke u bazuar në praktikën pozitive ndërkombëtare, Komiteti, në mbledhjen e vet të rregulltë të mbajtur në Sallën e Mbledhjeve të Kuvendit Komunal në Prishtinë, më 26.01.2017. miratoi këtë:

U D H Ë R R Ë F Y E S

MBI PUNËN DHE VEPRIMTARINË E KOMITETIT KONSULTATIV PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË KOMUNËN E PRISHTINËS PËR PERIUdhËN MANDATORE

I. HYRJA DHE QËLLIMI

Objektivat bazë të këtij Komiteti janë nxitja, mbrojtja dhe sigurimi i mundësisë që të gjithë Personat me Nevoja të Veçanta (më tutje: Persona me Aftësi të Kufizuara) në territorin e Komunës së Prishtinës t'i gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre, sa u përket specifikave të këtyre personave dhe sa i përket domenit të nivelit komunal të qeverisjes.

Personat me aftësi të kufizuar përfshijnë individët me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat, në ndërveprim me barriera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri, njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë.

E tërë puna dhe veprimtaria e Komitetit për këtë periudhë mandatore, në aspektin dinamik, varet nga koha e shtruarjes së çështjeve tematike nga Kryetari i Komunës, komitetet e përhershme, Kuvendi i Komunës, si dhe vetë Komiteti, e të cilat tema janë edhe pika orientuese të këtij Udhërrëfyesi, si:

- Dhënia e propozimeve të rregulloreve të ndryshme, hulumtime të ndryshme, mendime dhe ide rreth iniciativave të ndërmarra nga Kryetari i Komunës, komitetet e përhershme apo Kuvendi i Komunës në fushën përkatëse;
- Paraqitja e pikëpamjeve dhe mendimeve të qytetarëve persona me aftësi të kufizuara tek Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës; si dhe
- Propozime për zgjidhjen e problemeve të identifikuara.

Komiteti do t'i marrë në konsideratë parashtrirat apo propozimet eventuale të qytetarëve persona me aftësi të kufizuara apo të organizatave joqeveritare që i përfaqësojnë ata në nivelin komunal të qeverisjes në Prishtinë, lidhur me çështjet e targetuara nga përmbajtja dhe fryma e këtij Udhërrëfyesi.

Komiteti është i hapur dhe mirëpret bashkëpunimin me faktorë tjerë shoqëror më të specializuar në këtë lëmi dhe donatorë projektësh zhvillimore për persona me aftësi të kufizuara.

Sipas vendimit të lartshënuar, këto propozime, të cilat janë edhe të inkuorporuara në metodologjinë e këtij Udhërrëfyësi, kanë karakter konsultativ për Kuvendin e Komunës, dhe mund të merren parasysh në zhvillimin e politikave komunale.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës.

II. METODOLOGJIA E UDHËRREFYESIT

(I)

rregullativa, të dhënat dhe raportimi

1. RREGULLATIVA

Kryetari i Komunës dhe/apo Kuvendi i Komunës do t'i nxjerrin të gjitha aktet e duhura rregullative dhe administrative dhe të marrin masa të tjera për funksionimin efikas të Komitetit, duke përfshirë edhe buxhetimin e punës dhe aktiviteteve të tij, si dhe për zbatimin e të drejtave të njohura ligjore të nivelit komunal, dhe të specifikuara në këtë Udhërrëfyës, si:

1. Aktin administrativ mbi të drejtën ligjore që:

1.1. Personat me aftësi të kufizuara dhe shoqëruesit e tyre, gëzojnë beneficione në pagesa, në trafikun urban falas, ndërsa në ndërrurban bëhet me pagesën 50% të vlerës së biletës;

1.2. Operatorët privat dhe publik duhet të përcaktojnë vendet për persona me aftësi të kufizuara dhe të vendosin sinjale përkatëse. Këto vende janë të lira nga detyrimi fiskal të përcaktuar me udhëzim nga MT dhe Ministria e Infrastrukturës;

1.3. Personat me aftësi të kufizuara ta parkojnë veturën e vet pa kufizime në vendet që nuk pengohet qarkullimi normal i trafikut. Sipas nevojës ata duhet të tregojnë librezën që dëshmon statusin e tyre.

2. Aktin administrativ që organet përgjegjëse për miratimin e projekteve të infrastrukturës dhe të ndërtimit, nuk miratojnë asnjë projekt, në qoftë se në to nuk janë marrë parasysh përshtatjet e nevojshme dhe të mundshme për persona me aftësi të kufizuara.

3. Aktin administrativ që personat me aftësi të kufizuar në shërbime publike komunale kanë përparësi në zgjidhjen e kërkesave. Sipas nevojës ata duhet të tregojnë librezën që dëshmon statusin e tyre.

4. Aktin administrativ që personat me aftësi të kufizuar që i plotësojnë kushtet ligjore për t'u konsideruar si qytetarë me nevojë për strehim, në përfundim të vlerësimit të nevojës së tyre, përfitojnë një shtesë relevante pikash, mbi masën e vlerësuar.

5. Aktin administrativ që personat me aftësi të kufizuara lirohen nga çdo llojë takse dhe tatimi komunal.

2. të dhënat

1. Komiteti përkujdeset që në bashkëveprim me Institucionet Komunale të mbledhin dhe përpunojnë të dhëna, duke përfshirë informacione statistikore, kërkimore dhe nga shoqatat respektive, për numrin e saktë të personave me aftësi të kufizuara në territorin e Komunës së Prishtinës, me qëllim që këto Institucione të hartojnë dhe zbatojnë politika komunale që do i japin efekt këtij Udhërrëfyesi.

Procesi i mbledhjes dhe ruajtjes së këtij informacioni duhet:

1.1. Të jetë në përputhje me masat mbrojtëse ligjore, duke përfshirë Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave, për të siguruar konfidencialitetin dhe respektin për jetën private të personit me aftësi të kufizuara;

1.2. Ky informacion i mbledhur do të ndahet sipas rastit dhe do të përdoret për t'u ardhur në ndihmë institucioneve në vlerësimin e zbatimit të detyrimeve të tyre ndaj personave me aftësi të kufizuara, si edhe do të identifikojë dhe adresojë barrierat me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara gjatë ushtrimit të të drejtave të tyre.

2. Institucionet marrin përgjegjësinë për shpërndarjen e këtyre të dhënave dhe sigurojnë që ato të jenë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara dhe për të tjerët.

3. RAPORTIMI

1. Komiteti do ta paraqesë në Kuvendin Komunal çdo fundvit një raport me shkrim mbi punën e vet dhe mbi progresin e arritur brenda vitit.

2. Raporti i Komitetit duhet të bëhet në një proces të hapur dhe transparent.

3. Raporti mund të tregojë faktorë dhe vështirësi që ndikojnë në shkallën e plotësimit të detyrimeve të këtij Udhërrëfyesi.

4. Raporti i Komitetit mund të bëjë sugjerime dhe rekomandime të përgjithshme dhe konkrete. Këto sugjerime dhe rekomandime do të përfshihen në politikat komunale dhe strategjinë për persona me aftësi të kufizuara në territorin e Komunës së Prishtinës.

(II)

arsimimi, Aftësimi dhe Rehabilitimi i PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË KOMUNËN E PRISHTINËS

1. ARSIMIMI

Me qëllim realizimin e të drejtës pa diskriminim dhe mbi bazën e mundësive të barabarta të Personave me Aftësi të Kufizuara, Komiteti angazhohet që Institucionet Komunale të Arsimit të garantojnë një sistem arsimor gjithpërfshirës parauniversitar.

1. Për këtë qëllim institucionet duhet të marrin masat e duhura, duke përfshirë:

1.1. Lehtësimin e të mësuarit të alfabetit Braille, shkrimeve alternative, mënyrave augmentative/njohëse dhe alternative, mjeteve dhe formateve të komunikimit, aftësive të orientimit dhe lëvizshmërisë dhe lehtësimin e mbështetjes dhe kujdesit nga moshatarët;

1.2. Lehtësimin e të mësuarit të gjuhës së shenjave dhe nxitjen e identitetit linguistik të personave që nuk dëgjojnë;

1.3. Sigurimi i arsimimit të individëve, në veçanti fëmijëve, të cilët nuk kanë apo kanë shikim, të folur apo dëgjim të dobësuar, apo që nuk dëgjojnë e nuk shikojnë, në të njëjtën kohë të jepet në gjuhën, mënyrat dhe mjetet e komunikimit më të përshtatshme për individin dhe në ambiente të cilat rrisin zhvillimin arsimor dhe shoqëror të tij/saj.

2. Që të garantohet realizimi i kësaj të drejte, Komiteti insiston që Institucionet Komunale të Arsimit të marrin masat e duhura për punësimin e mësuesëve, duke përfshirë mësuesit me aftësi të kufizuara:

2.1. të cilët janë të kualifikuar në gjuhën e shenjave dhe/apo Braille;

2.2. të trajnojnë stafin që punon në të gjitha nivelet arsimore komunale, trajnime të cilat duhet të përfshijnë ndërgjegjësimin në lidhje me aftësinë e kufizuar dhe përdorimin e mënyrave të duhura augmentative/njohëse dhe alternative, mjeteve dhe formateve të komunikimit, teknikave edukuese dhe materialeve për të mbështetur personat me aftësi të kufizuara;

2.3. të sigurohen mësues mbështetës dhe asistentë personal për fëmijët me aftësi të kufizuara (në raste të domosdoshme) nëpër institucionet edukative-arsimore parafillore dhe parauniversitare.

3. Komiteti kërkon nga Komuna të ndajë bursa për studentët persona me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ata të jenë në gjendje të kenë qasje në arsimin e lartë, trajnime profesionale, arsimin për të rritur dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës pa diskriminim dhe në baza të barabarta me të tjerët, si dhe të mundësohet ofrimi i akomodimit të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuara.

2. Aftësimi dhe Rehabilitimi

1. Komiteti në bashkëpunim me Institucionet përkatëse komunale do të ndërmarrin masat e duhura, duke përdorur edhe mbështetjen e moshatarëve, për të bërë të mundur që personat me aftësi të kufizuara të arrijnë dhe të ruajnë pavarësinë e tyre maksimale, aftësinë e plotë fizike, mendore, shoqërore dhe profesionale, dhe për të siguruar përfshirjen dhe pjesëmarrjen e tyre të plotë në të gjitha aspektet e jetës.

Për këtë qëllim, këto institucione do të organizojnë, fuqizojnë dhe zgjerojnë shërbimet aftësuese dhe rehabilituese gjithëpërfshirëse, veçanërisht në fushat e shëndetit, punësimit, edukimit dhe shërbimeve sociale, në mënyrë të tillë që këto shërbime dhe plane:

1.1. Të fillojnë në fazën më të hershme të mundshme dhe të jenë të bazuara në vlerësimet multidisiplinare të nevojave dhe fuqive individuale;

1.2. Të mbështesin pjesëmarrjen dhe përfshirjen në komunitet dhe në të gjitha aspektet e shoqërisë dhe të sigurohen që ato janë mbi baza vullnetare të disponueshme për personat me aftësi të kufizuara sa më pranë komuniteteve të tyre të jetë e mundur, duke përfshirë zonat rurale.

2. Institucionet do të inkurajojnë organizimin e trainimeve të nivelit fillestar dhe të vazhdueshëm për profesionistët dhe stafin që punon në shërbimet aftësuese dhe rehabilituese.
3. Institucionet do të inkurajojnë disponibilitetin, njohuritë dhe përdorimin e pajisjeve dhe teknologjive asistuese të projektuara për personat me aftësi të kufizuar, duke qenë se ato lidhen me aftësimin dhe rehabilitimin.

(III)

Kujdesi Shëndetësor dhe mbrojtja sociale

1. KUJDESI SHËNDETËSOR

Institucionet Shëndetësore Komunale njohin faktin që personat me aftësi të kufizuar kanë të drejtën të gëzojnë standartin më të lartë të mundshëm shëndetësor pa diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar. Komiteti pret nga këto institucione të marrin masat e duhura për të siguruar qasjen e personave me aftësi të kufizuar ndaj shërbimeve shëndetësore, përfshirë rehabilitimin lidhur me shëndetin, në veçanti,:

1. Garantimin e së njëjtës gamë, cilësi dhe standarde adekuate të shërbimeve shëndetësore pa pagesë ose të përballueshme, duke përfshirë plane dhe shërbime në fushën e shëndetit seksual dhe riprodhues dhe plane të shëndetit public;
2. Garantimin e atyre shërbimeve shëndetësore që u nevojiten personave me aftësi të kufizuar, për shkak të aftësisë së tyre të kufizuar, duke përfshirë edhe identifikimin e hershëm dhe ndërhyrjen sipas rastit, si dhe shërbime të hartuara për të minimizuar dhe parandaluar përkeqësimin e aftësive të kufizuara, duke përfshirë fëmijët dhe të moshuarit;
3. Garantimin e këtyre shërbimeve shëndetësore sa më pranë të jetë e mundur komuniteteve të këtyre personave, përfshirë zonat rurale;
4. Parandalimin e mohimit diskriminator të kujdesit shëndetësor apo shërbimeve shëndetësore mbi bazën e aftësisë së kufizuar;
5. Kërkimin nga profesionistët e kujdesit shëndetësor që të ofrojnë kujdes të së njëjtës cilësi për personat me aftësi të kufizuar si për të tjerët, si dhe për të rritur ndërgjegjësimin mbi të drejtat, dinjitetin, autonominë e njeriut dhe nevojave të personave me aftësi të kufizuar nëpërmjet trainimeve dhe shpalljes së standardeve etike për kujdesin shëndetësor publik dhe privat.

2. MBROJTJA SOCIALE

1. Komiteti me Institucionet Komunale të Mirëqenies Sociale përkushtohen për të drejtën e personave me aftësi të kufizuar për një standard adekuat jetese për ta dhe për familjet e tyre, duke përfshirë ushqimin, veshjen dhe strehimin e përshtatshëm , si edhe të drejtën për përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të

jetesës dhe do të ndërmarrin hapat e duhura për të mbrojtur dhe përmirësuar realizimin e kësaj të drejtë pa diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar.

2. Institucionet njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuar për mbrojtje shoqërore dhe që ata ta gëzojnë atë të drejtë pa diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar dhe do të ndërmarrin hapat e duhura për të mbrojtur dhe përmirësuar realizimin e kësaj të drejte, duke përfshirë marrjen e masave:

2.1. Për të siguruar qasjen e personave me aftësi të kufizuar, në veçanti grave dhe vajzave me aftësi të kufizuar dhe personave të moshuar me aftësi të kufizuar në planet e mbrojtjes shoqërore dhe të përmirësimit të standardit jetësor;

2.2. Për të siguruar qasjen e personave me aftësi të kufizuar dhe familjeve të tyre që jetojnë në kushtet e varfërisë, në asistencën e ofruar nga Shteti për të mbuluar shpenzimet lidhur me aftësinë e kufizuar, duke përfshirë trainimin, këshillimin, asistencën financiare dhe kujdesin gjatë pushimeve;

2.3. Për të siguruar qasjen e personave me aftësi të kufizuar në planet e strehimit publik.

(IV)

Puna dhe punësimi

1. E drejta e punës garantohet, sipas nenit 49 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku thuhet edhe se secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës. Dispozitat e këtij neni pra kufizohen vetëm në të drejtën e punës dhe të zgjedhjes së profesionit dhe vendit të punës, por jo edhe të punësimit.

2. Ligji NR. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, në nenin 12, paragrafi 1, shprehimisht thotë: “Organet e administratës shtetërore, punëdhënësit e sektorit privat dhe publik, si dhe organizatat joqeveritare obligohen që, me kushtet e përshtatshme të punës t’i punësojnë personat me aftësi të kufizuara”. Ndërsa, në paragrafin 2: “Çdo punëdhënës është i obliguar të punësojë një person me aftësi të kufizuar në çdo 50 punëtor”.

Me kushte të veçanta, sipas kuptimit të këtij Ligji, personat me aftësi të kufizuara punësohen në Qendrën për Aftësimin, Riaftësimin Profesional, Punëtorinë Mbrojtëse dhe në Qendër Punuese, të cilët, në bazë të aftësive të punës dhe sipas kushteve të përgjithshme, nuk mund të punësohen në tregun e hapur të punës ose ta mbajnë punën e vet.

Punësim në kushte të veçanta konsiderohet edhe vetëpunësimi, si dhe punësimi në ekonominë familjare i personave me aftësi të kufizuara.

2. Mbështetur në legjislacionin në fuqi dhe nisur nga parimi bazë i barazisë sociale, Komiteti katërcipërisht i inkurajon dhe bashkëpunon ngushtë me Institucionet Komunale, që ta njohin dhe zbatojnë të drejtën e personave me aftësi të kufizuar për të punuar, njësoj si pjesa tjetër e popullsisë. Këtu përfshihet e drejta për të patur mundësinë për të fituar jetesën duke bërë punë të zgjedhur lirisht apo të pranuar në tregun e punës dhe vendin/ambientin e punës që është i hapur, përfshirës dhe i arritshëm nga personat me aftësi të kufizuar. Këto institucione duhet të mbrojnë dhe inkurajojnë realizimin e të drejtës për punë, duke marrë hapat e duhur, përfshirë masat ligjore me qëllim që ndër të tjera:

- 2.1. Të ndalojnë diskriminimin për shkak të aftësisë së kufizuar në të gjitha çështjet lidhur me punësimin, përfshirë kushtet e punësimit, vazhdimësisë së punësimit, ecjes në karrierë dhe ofrimin e kushteve të sigurta dhe të shëndetshme të punës;
- 2.2. Mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, njësoj si gjithë të tjerët, duke përfshirë garantimin e mundësive të barabarta dhe pagesës së barabartë për punën me vlerë, siguri dhe kushte pune të shëndetshme të barabarta, duke përfshirë dhe mbrojtjen nga ngacmimet dhe zgjidhjen e ankesave;
- 2.3. Për të garantuar që personat me aftësi të kufizuar të kenë qasje në planet e përgjithshme udhëzuese teknike dhe profesionale, në shërbimet e punësimit dhe për të garantuar trainim të vazhdueshëm dhe profesional ;
- 2.4. Nxitjen e mundësive për punësim dhe karrierë për personat me aftësi të kufizuar në tregun komunal të punës, si edhe ofrimin e asistencës për gjetjen, fitimin, mbajtjen dhe kthimin në punë;
- 2.5. nxitjen e mundësive për vetëpunësim, aktivitet të lirë privat, zhvillimin e kooperativave dhe hapjen e një biznesi personal;
- 2.6. Punësimin e personave me aftësi të kufizuar në sektorin publik;
- 2.7. Inkurajimin e punësimit të personave me aftësi të kufizuar në sektorin privat nëpërmjet politikave dhe masave të duhura, të cilat mund të përfshijnë plane pozitive veprimi, stimuj dhe masa të tjera;
- 2.8. Për të garantuar që personave me aftësi të kufizuar t'u sigurohet një akomodim i arsyeshëm në ambientin e punës;
- 2.9. Për të inkurajuar personat me aftësi të kufizuar të fitojnë përvojë pune në tregun e hapur të punës;
- 2.10. Për të promovuar plane për rehabilitim profesional, për mbajtjen e vendit të punës dhe ofrimin e planeve për kthimin në punë për personat me aftësi të kufizuar.

(V)

Pjesëmarrja në jetën publike, kulturore, argëtuese dhe sportive

Komiteti njih dhe inkurajon pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në jetën publike, kulturore, argëtuese dhe sportive të komunës dhe në bashkëpunim të ngushtë me Komunën, do të marrin të gjitha masat e duhura për të garantuar që personat me aftësi të kufizuar:

1. Ta kenë një ambient të përshtatshëm, në të cilin personat me aftësi të kufizuar mund të marrin pjesë në mënyrë efektive dhe të plotë në dirigjimin e çështjeve publike, pa diskriminim dhe njësoj si të tjerët dhe të inkurajojë pjesëmarrjen e tyre në çështjet publike, duke përfshirë:

1.1. pjesëmarrjen në organizatat joqeveritare dhe shoqatat që kanë të bëjnë me jetën publike dhe politike në vend dhe në aktivitetet dhe administrimin e partive politike;

1.2. krijimin apo pjesëmarrjen në organizata të personave me aftësi të kufizuar për të përfaqësuar personat me aftësi të kufizuar në nivele lokale, kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare.

2. Komiteti njeh dhe inkurajon pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara, njësoj si gjithë të tjerët, në jetën kulturore të Komunës dhe në bashkëpunim me institucionet do të marrin të gjitha masat e duhura për të garantuar që personat me aftësi të kufizuara:

2.1. Të gëzojnë qasje në materialet kulturore në të gjitha formatet e qasshme;

2.2. Të gëzojnë qasje në planet radio-televizive lokale apo difuzive, filmat, teatrot, dhe aktivitete të tjera kulturore, në formate të qasshme;

2.3. Të gëzojnë qasje në institucionet apo shërbimet kulturore: teatrot, muzeumet, kinematë, bibliotekat dhe shërbimet për turistët.

3. Komiteti dhe Institucionet duhet të marrin masat e duhura për të bërë të mundur që personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësinë për të zhvilluar dhe përdorur potencialin e tyre krijues, artistik, dhe intelektual, jo vetëm për të mirën e tyre, por gjithashtu për pasurimin kulturor të shoqërisë.

4. Personat me aftësi të kufizuara duhet të kenë të drejtën, njësoj si gjithë të tjerët, që t'u njihet dhe të mbështetet identiteti i tyre specifik kulturor dhe lingvistik, përfshirë dhe gjuhën e shenjave dhe kulturën e personave që nuk dëgjojnë.

5. Me qëllim që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë njësoj si gjithë të tjerët në aktivitete argëtuese, të kohës së lirë dhe sportive, Komiteti dhe Institucionet duhet të marrin masat e duhura:

5.1. Për të inkurajuar dhe nxitur pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në aktivitetet sportive gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet;

5.2. Për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësinë të organizojnë, zhvillojnë dhe marrin pjesë në aktivitete sportive specifike dhe argëtuese për aftësinë e kufizuara dhe për këtë qëllim, të inkurajojnë ofrimin e instruksioneve, trainimit dhe burimeve të duhura, njësoj si gjithë të tjerët;

5.3. Për të siguruar qasjen e personave me aftësi të kufizuara në terrenet sportive, argëtuese dhe turistike;

5.4. Për të siguruar qasjen e barabartë të fëmijëve për të marrë pjesë në lojra, argëtime, aktivitete sportive dhe të kohës së lirë, duke përfshirë edhe aktivitetet që zhvillohen në sistemin shkollor;

5.5. Për të siguruar qasjen e personave me aftësi të kufizuara në shërbimet argëtuese, turistike, sportive dhe të kohës së lirë.

(VI)

Bashkëpunimi NDËRINSTITUCIONAL DHE me organizmat tjera

1. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

1. Komiteti pranon rëndësinë e bashkëpunimit dhe nxitjen e tij, në mbështetje të përpjekjeve institucionale për realizimin e qëllimit dhe objektivave të këtij Udhërrëfyesi dhe do të ndërmarrin masat e duhura dhe efektive në këtë drejtim, midis subjekteve dhe faktorëve relevant dhe sipas rastit në partneritet me organizatat përkatëse ndërkombëtare që veprojnë këtu dhe me shoqërinë civile, në veçanti organizatat për personat me aftësi të kufizuara. Këto masa, ndër të tjera, mund të përfshijnë:

1.1 Sigurimin e bashkëpunimit institucional, duke përfshirë edhe planet ndërkombëtare të zhvillimit për personat me aftësi të kufizuara;

1.2. Lehtësimin, mbështetjen dhe ngritjen e kapaciteteve, midis tjerash, nëpërmjet shkëmbimit dhe ndarjes së informacionit, përvojës, planeve të trainimit dhe praktikës më të mirë;

1.3. Lehtësimin e bashkëpunimit në punën kërkimore dhe qasjen në njohurinë shkencore dhe teknike; dhe

1.4. Sigurimin, sipas rastit, e asistencës teknike dhe ekonomike, përfshirë dhe sigurimin e qasjes dhe përdorimit të përbashkët të teknologjisë assistive dhe të qasshme, si edhe nëpërmjet transferimit të teknologjisë;

1.5. Çdo institucion do të bashkëpunojë me Komitetin dhe do t'u vijë në ndihmë anëtarëve të tij në përmbushjen e mandatit të tyre;

1.6. Komiteti, në marrëdhëniet e tij me Institucionet, do t'i kushtojë vëmendjen e duhur rrugëve dhe mënyrave për rritjen e kapaciteteve institucionale për zbatimin e këtij Udhërrëfyesi.

2. Marrëdhëniet e Komitetit me organizmat tjera

Me qëllim nxitjen e zbatimit të plotë dhe me efikasitet të këtij Udhërrëfyesi dhe bashkëpunimit me organizmat tjerë në fushat e përcaktuara në këtë Udhërrëfyesi:

1. Komiteti mund të ftojë institucione të specializuara dhe individë kompetentë, siç mund ta shohë të përshtatshme, për të siguruar këshillim të specializuar lidhur me zbatimin e Planit, në ato çështje që bëjnë pjesë në mandatet e tyre përkatëse;

2. Komiteti, në kuadër të realizimit të mandatit të tij, do të konsultohet, siç të jetë e përshtatshme, me organe tjera relevante të institucionalizuara për të drejtat e njeriut, me qëllim arritjen e konsistencës të udhëzimeve të tyre raportuese përkatëse, sugjerimeve dhe rekomandimeve të tyre të përgjithshme dhe do të mënjanojë duplikimin apo mbivendosjen në realizimin e këtyre funksioneve;

4. Parashtresat dhe/apo iniciativat e organizatave joqeveritare lokale të personave me aftësi të kufizuara, si dhe të individëve, do të adresohen në Komitet, për tu proceduar më tutje;

5. Komuna do të bashkëveprojë me Komitetin, për çdo nismë që ka të bëjë me persona me aftësi të kufizuara në këtë Komunë.

III. PËRFUNDIMI DHE REKOMANDIMET

Në nivel komunal e as në atë qendror nuk ka një burim statistikor për persona me aftësi të kufizuara. Por, sipas disa parametrave tjerë, si: më së 7200 përfitues të pensioneve për persona me aftësi të kufizuara, që dalin nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe më së 10000 nxënës persona me aftësi të kufizuara, nga Ministria e Arsimit, del se numri i personave me aftësi të kufizuara në Kosovë mund të jetë rreth 18000 persona.

Nëse krahasohet numri i personave me aftësi të kufizuara me numrin statistikor të popullsisë së përgjithshme prej 1.739.825 banorë, atëherë del se në Kosovë, personat me aftësi të kufizuara përbëjnë rreth 1% të populates, kurse në Komunën e Prishtinës mbi 1.3%.

Bazuar në masën prej 10% të popullatës persona me aftësi të kufizuara në raport me popullatën e përgjithshme që e llogarit Organizata Botërore e Shëndetësisë gjithandej në botë, del se popullsia e Kosovës, e në kuadër të kësaj edhe ajo e Prishtinës, është me më së paku persona me aftësi të kufizuara - është ndër më të shëndoshat.

Krahasimi i këtyre numrave dhe përqindjeve të personave me aftësi të kufizuara me përqindjen njëshifrore të të punësuarve nga këta persona, që është në Kosovë (prej 0.46% e të verbërve deri 7.49% e “njerëzve të vegjël”), e dëshmon pozitën e palakmueshme të tyre në shoqërinë kosovare.

- ◆ Është ky një sinjal i qartë për institucionet e të gjitha niveleve dhe të faktorëve tjerë se, vetëm me miratimin e ligjeve, nuk përmirësohet statusi i këtyre personave.
- ◆ Një këso përqindje kaq e vogël e këtij popullacioni nuk është barrë e rëndë për shoqërinë kosovare, e në veçanti për Komunën e Prishtinës, për ta integruar atë në të gjitha sferat e jetës.
- ◆ Komiteti angazhohet dhe inkurajon organizatat joqeveritare të personave me aftësi të kufizuara dhe individët e këtij komuniteti që t’i unifikojnë sa më shumë që të jetë e mundur punën, aktivitetet dhe organizimin e tyre. Sa më unik të jemi, aq më lehtë i realizojmë të drejtat tona.
- ◆ Personat me aftësi të kufizuara janë asset i shoqërisë sonë, prandaj Komiteti e fton Komunën që të reflektojë.